



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 87

Prishtinë, më 15.7.2013, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S1

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi, Behar Selimi, Arsim Bajrami, Mufera Şinik, Ardian Gjini, Haki Demolli, Halit Krasniqi, Armend Zemaj dhe Albulena Haxhiu.

Munguan: Gëzim Kelmendi dhe Sreten Ivanović.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Alban Sutaj dhe Drita Rexhepi – ANFJ, Ilir Gashi – ZPRK, Petrit Hysaj – OSBE, Artan Canhasi – EULEX, Vlora Marmullakaj – EULEX, Fjolla Gashi – Kuvendi i Kosovës, Tringa Bytyqi, Labinot Llapashtica, Rebeka Malqi dhe Qendresa Nasuri, - praktikantë.

Nga stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 10 dhe 11.6. 2013;
3. Shqyrtimi i raportit vjetor i punës së Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, për vitin 2012;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-198 për tregtinë e mallrave strategjike;
5. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Behar Selimi propozoi që pikë e rendit të ditës të jetë edhe Projektligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar për çështjet penale, e që bën pjesë në pakon e ligjeve që kërkohen të miratohen për çështjen e Integriteteve.

Albulena Haxhiu - Tha se është kundër futjes në rend të ditës Projektligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar, pasi që sapo e kanë marrë projektligjin dhe kërkon kohë për t'u shqyrtuar në detaje, dhe propozojë që të shtyhet për ndonjë ditë tjetër.

Ardian Gjini - Dha sqarime se ky projektligj nuk është diskutuar në kryesi, dhe për t'u proceduar më tutje duhet që në seancë të votohet për shmangie të rregullores dhe nuk e kam akoma të qartë se çfarë po ndodh?

Behar Selimi- Tha se ne, si Komision FunkSIONAL, të kryejmë punën tonë, pa përjashtim të procedurave të rregullta, dhe mbi bazën e rregullores së punës ta kalojmë në parim, e pastaj le të vazhdojë procedurën e rregullt.

Ardian Gjini – Tha se ashtu sikur unë besoj që edhe shumica e antarëve të tjerë nuk e kan lexuar projektligjin dhe nuk e shoh të nevojshme këtë ngutësi kaq të madhe, meqenëse ky projektligj do të dalë të enjten në seancë, dhe ne prapë do të kemi kohën të mjaftueshme që deri të hënën t'i paraqesim propozimet tona si komision.

Armend Zemaj – Tha se kisha propozuar që nëse ky projektligj është kaq shumë për ngutësi, që të takohemi nesër dhe të diskutojmë për këtë projektligj, që së paku anëtarët e Komisionit ta kenë së paku mundësin ta lexojnë projektligjin, edhe kemi kohë që ta procedojmë për seancën e së enjtes nëse është e nevojshme.

Kryetari – Tha se po nxitohemi, sepse qeveria e ka mbajtur një muaj projektligjin, dhe po të ishte e nevojshme do ta kishin sjellë më herët, kështu që nuk kemi nevojë ta fusim Kuvendin në një procedurë kaq të shpejtë pa e studiuar materien mirë.

Arsim Bajrami – Tha se nuk mendoj se ky projektligj do të arrijë të futet në seancë për ditën e enjte, andaj mund ta diskutojmë edhe sot një javë.

Behar Selimi – Tha se ne jemi që ta ndjekim procedurën, për shkak se ky projektligj është i këtij Komisioni. Në kuadër të rregullores lejohet, që në rend të ditës të futet edhe projektligji tjetër. Idea ime nuk ka qenë që të shkojmë me shmangie, por që projektligji të aprovohet në parim edhe të futet në procedurë të rregullt. Megjithatë, meqenëse anëtarët nuk e kanë lexuar, dhe meqenëse ky projektligj mund të shkojnë në kuadër të asaj pako me ndonjë procedurë tjetër, unë e tërheq propozimin.

Kryetari konstatoi se rendi ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 10. dhe 11.6. 2013

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 10. dhe 11.6. 2013, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor i punës së Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, për vitin 2012

Kryetari – Ju e dini se heren e kaluar kur ka ardhur ky raport ka pasur vërejtje substanciale, andaj Komisioni pati vendosur që t'i kthehet raportuesit raporti për përmirësim. Tash para nesh kemi raportin e ri, para se të marrin fjalën raportuesit a ka dikush për të shtuar ndonjë gjë? Meqenëse nuk ka kush për të shtuar, fjalën e ka drejtori i Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas.

Alban Sutaj paraqiti raportin e punës së Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas për vitin 2012, që pasqyron punën, sfidat dhe arritjet njëvjeçare të kësaj agjencie. Agjencia për ndihmë juridike falas, vazhdon të jetë një institucion i rëndishëm në ofrimin e shërbimeve juridike për qytetarët e Republikës së Kosovës. Aktualisht Agjencia për ndihmë juridike falas vepron në 13 zyre gjithsejtë, nga të cilat 5 financohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës, dhe atë në: Prishtinë, Prizren, Mitrovicë, Gjilan dhe Pejë. Kurse nga projekti për Avancimin e Barazisë Gjimore, financohen 8 zyre. Numri i lëndëve për vitin 2012 ka qenë 3.940 lëndë.

Gjithashtu nëse më lejoni dua të ju njoftoj se projekti i UNDP-së që përkrah 8 zyret që nuk financohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës, zyrtarisht përfundon më 31 dhjetor dhe këto 8 zyre rrezikohen që të mbyllen. Andaj paraqitet nevoja që edhe këto 8 zyre të integrohen në Agjencinë për Ndhimë Juridike Falas, në mënyrë që të sigurohet shërbime sa më të mira për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe të mund të realizojnë të drejtat e tyre.

Kryetari- Tha se sa i përket pjesës shitesë të raportit që ka të bëjë me 8 zyrat që financohen nga UNDP, mendoj se duhet t'i drejtoheni Ministrisë së Drejtësisë dhe nëse ka nevojë edhe Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe së bashku me ta të shikohet se si mund të rregullohet kjo çështje. Duke parë që një zyre shpenzon rreth 45 000 euro dhe janë 8 zyre, që bëjnë rreth 365 000 euro , a ka buxhet apo jo nuk po mundem të paragjykoj?

Armend Zemaj - Vlerësoi se po të isha pyetur unë, ose do e kisha mbyllur këtë agjenci, ose do ta kisha shëndrruar në një dikaster pranë Ministrisë së Drejtësisë, në mënyrë që t'iu ofrohen këto shërbime qytetarëve. Arsyeja se po e them këtë ka të bëjë edhe përshkak të shërbimeve që ofron gjer më tani kjo agjenci, por edhe nga kostoja. Eficienca e punëve që bëhen në këtë Agjenci nuk përshkruhet në këtë agjenci, përpos punëve se çfarë bëjnë dhe nuk paraqiten sfidat dhe nuk ka rekomandime të qarta se çfarë duhet të bëhet më tutje. Unë e kam një vërejtje, sepse nga 2-3 qytetarë me të cilët kam biseduar, kanë thënë se ndihma e ofruar ka qenë vetëm formale, do të thotë kualitet nuk ka. Nëse buxheti i Kosovës i financon këto agjenci dhe nuk kthehen në shërbime efikase atëherë diçka nuk është në rregull. Akoma qytetarët nuk janë të njoftuar se a ekziston kjo agjenci apo jo?

Ardian Gjini - Tha se Kuvendi e ka themeluar këtë institucion për t'ju ofruar ndihmë juridike falas personave që nuk kanë mundësi të paguajnë për këto shërbime. Kjo agjenci nuk është themeluar për të krijuar vende të reja pune, por në aspektin institucional është themeluar pikërisht për të ofruar shërbimet juridike. Çështja e dytë, është se duhet të diskutohet në Ministrinë e Drejtësisë se sa ka nevojë për këtë agjenci dhe a duhet të vazhdoj kështu, sepse ndoshta më shtrenjët po na kushton kështu se sa të paguajmë drejtpërdrejt ndonjë avokat për këto shërbime, e që do të ishin edhe më kualitative. Ishte i mendimit se këtë raport duhet ta kalojmë tutje përshkak se për momentin nuk kemi zgjidhje tjetër. Mirëpo Komisioni të iniciojë një procesë për të vlerësuar, vlerën e investimit në këtë drejtim dhe të shikohet arsyeshmëria financiare e kësaj agjencie.

Behar Selimi – Tha se raporti është i pranueshëm dhe duhet të kaloj. Së dyti , agjencia po ofron mundësi për qytetarët që nuk kanë mundësi, dhe së treti mendoj se nuk duhet të humbim shumë kohë dhe t'i drejtohem Komisionit për Buxhet e Financa që të rrisë buxhetin për këtë agjenci, në mënyrë që edhe pas këtij viti të vazhdojnë të ofrohen këto shërbime edhe në 8 zyret e tjera.

Albulena Haxhiu - Fillimisht dua të pyes lidhur me shpalljen e konkursit, se a është bërë vlerësimi paraprak i punës së zonjës Morina, pra a ka bërë dikush nga këshilli apo bordi i kësaj agjencie një vlerësim të tillë, pasi që sipas ligjit të shërbyesve civilë duhet të bëhet vlerësimi i punës së të punësuarve. Së dyti, nuk pajtohem me z. Zemaj që tha se duhet të mbyllet agjencia, duke pasur parasysh gjendjen e qytetarëve tanë. Sa i përket lëndëve të regjistruara e pashë se janë 617 lëndë, mirëpo në asnjë raport gjer më tani, pra është viti i tretë i raportimit, nuk kemi parë se sa raste keni

fituar, në sa raste vendimi është marrë në favor të palës që i'u është drejtuar. Dhe shpresoj që në raportet e ardhshme ta paraqitni edhe këtë. Sa i përket buxhetit, nuk e di cili është roli i Komisionit për t'iu drejtuar Ministrisë për rritjen e buxhetin. Shumë qytetarë as nuk e dijnë se ekziston një agjenci e tillë.

Haki Demolli- Theksoi se është e vërtetë se agjencia është themeluar. Edhe pse është themeluar ajo në radhë të parë parashihet me dispozitat kushtetuese, dhe në radhë të dytë vërtet qytetarët të cilët e kanë gjendjen e rëndë, kanë nevojë për këto shërbime. Ajo që nga të gjithë anëtarët e Komisionit u diskutua ka të bëjë me kualitetin e këtyre shërbimeve. Prandaj kam një propozim që Agjencia për Ndihmë Juridike Falas së bashku me Ministrinë e Drejtësisë dhe me aktorët e tjerë relevant të bëjë një analizë sa i përket punës së kësaj agjencie, si në aspektin e përcaktimit të parametrave se kur konsiderohet një rast i mbrojtur dhe parametrave të tjerë. Pas një analize të tillë, mund të dilet me rekomandime, për rritjen e buxhetit të kësaj agjencie ose edhe çështjeve të tjera. Çështja e dytë, aty në faqen 27 të raportit përmendet Bashkëpunimi Ndërkombëtar, ku flitet për bashkëpunim ndërkombëtar, mirëpo përpos me Shqipërinë që ka pasur disa kontakte nuk pashë diçka tjetër. Dhe çështja e tretë, u përend kryerja e programit të UNDP- së, a keni kontaktuar edhe me organizatat e tjera ndërkombëtare për financimin e këtyre 8 zyrave?

Halit Krasniqi – Tha se mendoj që Agjencia për Ndihmë Juridike Falas duhet ta gëzojë mbështetjen e Kuvendit dhe mendoj se dita ditës kjo agjenci do të filloj të forcohet. Ky numër i lëndëve të trajtuara nuk mund të kalojë pa përshtypje, por duhet të i jepet shancë që agjencia të dëshmojë veten dhe kërkesa për rritje të buxhetit është e arsyshme, dhe duhet gjithashtu të bëhet një fushatë përmes mediave për ekzistimin e agjencisë dhe shërbimeve që ofron. Ju inkurajoj për punën e metutjeshme.

Kryetari propozoi të formohet një grup punues që të shqyrtohet raporti analitik për të vlerësuar mundësin për përkrahjen e 8 zyrave që deri më tani janë mbështetur nga UNDP-ja. Për kryesues u propozua Armend Zemaj, ndërsa Behar Selimi dhe Albulena Haxhiu anëtarë.

***Kryetari** konstatoi se Komisioni me “ një” abstenim vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:*

R e k o m a n d i m

Të shqyrtohet dhe të miratohet Raporti i punës së Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2012.

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-198 për tregtinë e mallrave strategjike

Kryetari – Paraqiti për shqyrtim raportin me amendamentet të Komisionit FunkSIONAL, në Projektligjin nr. 04/L-198 për tregtinë e mallrave strategjike, dhe kërkoi nga anëtarët që të deklarohen, nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr. 04/L-198 për tregtinë e mallrave strategjike, dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

5. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës

Komisioni e shqyrtoi vendimin e Qeverisë së Kosovës, nr. 03/136 të datës 26.6.2013, me të cilin për anëtar të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor u propozua Fekë Sadikaj. Në bazë të dokumentacionit të ofruar nga propozuesi për kandidatin, Komisioni vlerësoi se i përmenduri i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 3.3. të Ligjit për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës për anëtar të Këshillit Drejtues të Institutit.

Kryetari konstatoi se Komisioni me 4 vota “për” dhe 2 “kundër” dhe vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të emërohet Fekë Sadikaj anëtar i Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës

6. Të ndryshme

- **Njoftim me Shkresën e Gjykatës Kushtetuese për rastrin KO95/13**

Kryetari e paraqiti për njoftim Shkresën e Gjykatës Kushtetuese për rastrin KO95/13 dhe i informoi anëtarët me përmbajtjen e tij.

Mbledhja përfundoi në orën 13:05

E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit

Arben Gashi